



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 020/04/ 14102 dt. 25.03 2020

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Vendimit të Qeverise së Republikës së Kosovës Nr.01/07, i datës 11.03.2020, me qëllim të parandalimit të infeksionit Corona Virus COVID-19, Planit të Reagimit Kombëtar, nenin 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M


Për formimin e Shtabit Emergjent në Komunën e Drenasit, i plotësuar

I. Formohet Shtabi Emergjent për zbatimin e masave preventive ndaj virusit COVID-19, në këtë përbërje:

1. Ramiz Lladrovci, (kryetar),
2. Nazmi Hasi, Nënkyetar i Komunës,
3. Drejtoret e Drejtorive Komunale,
4. Ismet Bogiqi, Drejtor në QKMF,
5. Feime Bajrami, Komandante e Stacionit Policor në Drenas,
6. Kastriot Berisha, KRM "Pastrimi" dega Drenas,
7. Ismet Baliu, KRU "Ujësjiellësi" dega Drenas,
8. Florim Hajdari, KEDS, dega Drenas,
9. Afrim Gjeli, Zjarrfikëset Drenas,
10. Qendrim Mulaj, Asamblea Komunale,
11. Petrit Gashi, Asamblea Komunale,
12. Sokol Bylykbashi, Asamblea Komunale.

R. LI

- II. Shtabi Emergjent ka për obligim të monitoroj gjendjen në Komunën e Drenasit, pas vendimit të Qeverisë së Kosovës, lidhur me masat preventive ndaj virusit COVID-19.
- III. Ky Shtab Emergjent, çdo veprim duhet të ndërmarr në përputhje me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKSHP).
- IV. Shtabi Emergjent në mënyrë të vazhdueshme dhe profesionale, duhet të raportoj në lidhje me gjendjen në Komunën e Drenasit, duke kërkuar nga të gjithë akterët e nevojshëm të shtojnë vigjilencën, me qëllim të parandalimit të këtij virusi.
- V. Me këtë vendim, plotësohet vendimi Nr. 01-020/04-13622, i datës 12.03.2020 dhe vendimi Nr. 01-020/04-14065, i datës 23.03.2020.
- VI. Vendimi hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.


Kryetari i Komunës
Rafiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtarëve të Shtabit Emergjent;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.